

# Koncept dokument për Grupet Punuese të Reformës së Administratës Publike (RAP)

- Autor: CEP
- Data: Dhjetor 2016

## Përshkrim i shkurtër: Qfarë janë Grupet Punuese të nivelit kombëtar për RAP (GPK-të)?

GPK-të janë mekanizma konsultative të nivelit kombëtar për pjesëmarrjen e shoqërisë civile në dialogun me institucionet publike relevante për **monitorimin e proceseve të reformës së administratës publike (RAP)** në shtetet e Ballkanit Perëndimor.<sup>1</sup> GPK-të konsultohen në secilin shtet të Ballkanit Perëndimor, dhe shërbejnë si degë të mekanizmit më të gjerë për dialogun në kuadër të RAP, që njihet si Platforma Rajonale WeBER.<sup>2</sup>

### **WeBER Platform**

*Regional consultative platform, consisting of WeBER partners + 2 to 3 organisations per WB country*

*WeBER Platform members from each WB country as known as*  
**“National Consortium”**

*National consortium in each country are led by respective WeBER partner and are at the same time*

### **NWG Coordinators**

### **NWG**

*National consultative mechanism. Extension of the Platform to the national level*

Si pjesë integrale e Platformës WeBER, në funksionimin e tyre, GPK-të ndjekin parimin që vetëm përmes fuqizimit të akterëve jo-qeveritar lokal dhe forcimit të demokracisë pjesëmarrëse, në nivel qendror dhe lokal, mund të ruhet presioni i njëjtë ndaj qeverive për të vazhduar reformat në administratë, që shpesh janë të dhimbshme dhe jo të favorshme, edhe në periudhën pas anëtarësimit. Andaj, GPK-të sigurojnë që organizatat e shoqërisë civile me bazë në komunitet të përfshihen në dialogun për RAP, si në nivel qendror ashtu edhe atë lokal. Duke ndjekur linjën e njëjtë, GPK-të krijojnë rrjete të organizatave të shoqërisë civile në secilin shtet, për të marrë pjesë në diskutimet dhe konsultimet për procesin e monitorimit të reformës së administratës publike,<sup>3</sup> dhe adresimin e çështjeve relevante për secilin

shtet.

GPK-të formohen, udhëhiqen dhe koordinohen nga partnerët respektiv të projektit WeBER, duke mundësuar që edhe organizatat tjera të shoqërisë civile të marrin pjesë drejtpërdrejtë në platformën rajonale WeBER.<sup>4</sup> Në Kosovë, rolin e koordinimit e ka Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS).

<sup>1</sup> Ky koncept dokument është pjesë e projektit tre vjeçar WeBER (Western Balkans Enabling Project for Civil Society Monitoring of Public Administration Reform - WeBER), i financuar nga Bashkimi Evropian dhe bashkë-financuar nga Mbretëria e Holandës. Vizitoni ueb faqen e WeBER: <http://www.par-monitor.org/>.

<sup>2</sup> Nga koncept dokumenti për platformën WeBER. Platforma WeBER është platformë rajonale për konsultime, që drejtohet nga organizatat të shoqërisë civile nga shtetet e Ballkanit Perëndimor. Qëllimi i platformës është lehtësimi i dialogut me institucionet publike për procesin e reformës në administratën publike (RAP) në shtetet e Ballkanit Perëndimor, proces ky që realizohet paralelisht në secilin nga këto shtete. Për më shumë informata rreth platformës WeBER vizitoni ueb faqen: <http://www.par-monitor.org/pages/purpose>

<sup>3</sup> Monitori i RAP është shtylla kryesore e platformës WeBER dhe përfaqëson themelin e të gjitha aktiviteteve që zhvillohen në kuadër të Platformës. Kjo Platformë ofron metodologjinë dhe të gjitha resurset e nevojshme për monitorimin e pavarur të RAP nga ana e organizatave të shoqërisë civile. Monitorimi bazohet në informatave të bazuara në fakte që ofrohen këto organizata, ndërkohë që metodologjia ndjek parimet e administratës publike të zhvilluara nga SIGMA.

<sup>4</sup> Partnerët implementues të WeBER janë gjashtë institute të specializuara nga shtetet e Ballkanit Perëndimor, që njëkohësisht janë anëtare të Think for Europe Netëork (TEN). Organizatat e shoqërisë civile që implementojnë projektin janë: 1) Qendra Evropiane për Politika (CEP), Beograd, 2) European Policy Institute (EPI), Shkup, 3) Instituti Alternativa (IA), Podgoricë, 4) Instituti për Ndërmjetësim dhe Demokraci (IDM), Tiranë, 5) Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), Prishtinë, dhe 6) Iniciativa për Politikë të Jashtme BeH (FPI), Sarajevë.

## Si funksionojnë në thelb GPK-të?


GPK-të rrjedhin nga logjika dhe struktura e Platformës WeBER (e paraqitur në grafikun e mëposhtëm), e cila ofron një forum të përbashkët për pjesëmarrjen e organizatave të shoqërisë civile në monitorimin e RAP dhe dialogun që zhvillohet në nivel rajonal dhe në nivel të vendit. Secili konzorcium në kuadër të platformës paraqet një GPK për shtetin përkatës, duke pasur gjithnjë parasysh specifikat e mjedisit në të cilin operojnë organizatat e shoqërisë civile, si dhe disponueshmëria dhe nevoja për hulumtime të bazuara në fakte si dhe avokim për RAP. Megjithatë, qëllimi kryesor i themelimit të GPK-ve është mbledhja e sa më shumë organizatave të shoqërisë civile dhe krijimi i një mekanizmi vendor kredibil, që përfaqëson pikëpamjet dhe qëndrimet e shoqërisë civile në dialogun me institucionet shtetërore rreth procesit të monitorimit të RAP.

**Anëtarësia** në GPK i mundësohet të gjitha organizatave, me kusht që :1) Të dorëzojnë deklaratën përmes së cilës shprehin interesimin e organizatës për anëtarësim, dhe 2) të demonstrojnë se në fushëveprimin e tyre të kenë elemente që ndërlidhen me RAP (apo përvojë bazike në çështjet që ndërlidhen me RAP), apo shprehje të gatishmërisë për të qenë aktive në këtë fushë. Kjo do të bëhet përmes Thirrjes publike për të shprehur interesimin për anëtarësim në GPK.

**Qëllimi** i GPK-ve është të marrin pjesë në diskutimet dhe konsultimet për monitorimin e RAP, për raportet e monitorimit në nivel rajonal dhe vendor të cilat do të përgatitet në kuadër të projektit WeBER, si dhe adresimin e çështjeve relevante në fushën e RAP për secilin shtet (.p.sh diskutimi i vlerësimeve të SIGMA dhe raporteve të progresit të Komisionit Evropian, rezultatet nga takimet e grupit special për RAP, identifikimin e temave në të cilat duhet përqendruar në të ardhmen). Në takimet e GPK do të marrin pjesë edhe përfaqësues të institucioneve relevante të administratës publike (para së gjithash ministrive/zyrave për RAP, por edhe institucioneve tjera).

GPK-të do të funksionojnë në përputhje me dokumentet konstituive (memorandumet e bashkëpunimit, apo dokumente të ngjashme), planeve të punës dhe udhërrëfyesve që do të zhvillohen në kuadër të projektit. GPK-të do të dizajnohen dhe themelohen si aktivitete në kuadër të projektit WeBER, por puna dhe funksionimi i tyre do të vazhdoj përtej kohëzgjatjes së projektit.

Grafikoni i platformës WeBER



Organizatave që udhëheqin dhe koordinojnë GPK-të (që ndryshe njihen si konzorciume), e që njëkohësisht janë anëtare të platformës në nivel rajonal përfshijnë:

- Grupi për Studime Juridike dhe Politike - GLPS, Koordinator i GPK dhe WeBER për Kosovë;
- Intituti GAP, Prishtinë
- Insituti për Zhvillim të Politikave –INDEP, Prishtinë
- Iniciativat për Progres – INPO, Ferizaj

Anëtarët e platformës në Kosovë, si dhe anëtarët e platformës në shtetet tjera janë përzgjedhur përmes thirrjes publike për shprehje të interesit.

## Pse të anëtarësoheni në platformën WeBER dhe GPK-të?

Natyra e veçantë e platformës WeBER dhe GPK-ve, mbështetet në qasjen gjithpërfshirëse e cila përqendrohet në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe ndërtimit të partneritetit shumë shtresor në mes të organizatave të shoqërisë civile, me qëllim të rritjes së ndikimit në monitorimin e proceseve në RAP.

Në veçanti, GPK-të:

- Përfshijnë organizatat lokale që shprehin interesim të theksuar apo janë duke monitoruar punën e institucioneve në nivel lokal ose rajonal
- Krijojnë mundësi për zhvillimin e kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile përmes trajnimeve, punëtorive dhe mbështetjes në implementimin e metodologjisë për monitorimin e RAP, në nivel qendror dhe lokal
- Krijojnë mundësi për organizatat lokale me pak përvojë në fushën e RAP që të nisin ndërtimin e portfolios rreth RAP, duke i inkurajuar kështu që të propozojnë projekte [dhe aplikojnë për grante të vogla për monitorimin e reformës së administratës publike](#).

## Në të ardhmen (e afërt): Hapat e parë

- Konsultimet në nivel të vendit dhe përgatitja e koncept dokumentit

Në secilin shtet koncept dokumentet për GPK-të do të shpërndahen organizatave të shoqërisë civile. Secili nga anëtarët e konzorciumit do të ftohet të marrë pjesë në takimet konsultative. Rezultatet nga konsultimet do të integrohen në concept dokumentin përfundimtar për dizajnimin e GPK.

- Thirrja për shprehjen e interesit

Pasi të jenë vënë koncept dokumentet në dispozicion për konsultim, do të publikohet thirrja për organizatat e shoqërisë civile për tu bashkangjitur në GPK, me qëllim që të krijohet një rrjet sa më i gjerë i organizatave, duke pasur gjithnjë parasysh kapacitetin bazik dhe përvojën e organizatave, si dhe vullnetin dhe motivimin e tyre për të qenë pjesë e monitorimit të RAP. Numri i pjesëmarrësve në GPK do të përcaktohet nga konzorciumet e shteteve përkatëse.

- Themelimi i GPK-ve

Pas regjistrimit të organizatave të shoqërisë civile do të organizohet takimi për konstituimin e GPK. Në këtë takim do të nënshkruhen dokumentet konstituive të GPK (memorandum i bashkëpunimit apo dokumente të ngjashme, varësisht nga vendimi i secilit konzorcium)

- Takimet e GPK-ve:

Pas takimeve të para konstituive që do të zhvillohet në fillim të vitit 2017, GPK-të, do të organizojnë dy takime të tjera në secilin shtet. Të dy këto takime do të jenë konsultative:

- Takimi i dytë GPK-ve do të zhvillohet më vonë gjatë vitit 2017, dhe do të shërbejnë për të organizuar konsultimet afatmesme për progresin në hulumtimin dhe punën analitike në zbatimin e metodologjisë së monitorimit të RAP, koordinimin me projektet dhe iniciativat e organizatave të tjera, që janë relevante dhe mund të kontribuojnë në Monitorin e RAP, si dhe diskutimeve për ngritjen e fondeve për mbështetje shtesë për Monitorin e RAP dhe punën e GPK-ve;

- Takimet e tretë të GPK-ve në vitin 2018 do të organizohet në secilin shtet në koordinim me sesionet për hartimin e metodologjisë për monitorimin e RAP, ku do të diskutohen draftet e raporteve të shteteve përkatëse.